



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E  
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,  
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,  
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 112 Prot.

Lezhë, më 07 / 01 / 2025

URDHËR

Nr. 5., datë 07 / 01 / 2025

“PËR

KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR SHQYRTIMIN DHE ANALIZIMIN PËR  
PLANIN VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2025-2030,  
NË BASHKINË LEZHË”

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendim Nr. 393., datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”, Vendim Nr. 88., datë 22.02.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim europian 2022-2030”, Vendim Nr. 271., datë 02.05.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për migracionin 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024-2026”, Vendim Nr. 173., datë 24.03.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030”, Vendim Nr. 621., datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, si dhe Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030” ;

URDHËROJ:

1. Krijimin e grupit të punës për shqyrtimin dhe analizimin të Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030, në bashkinë Lezhë, si më poshtë;

- **Elson Frroku** – Kryetar, me detyrë Zv. Kryetar në Bashkinë Lezhë;
- **Vasilika Laska** – Koordinator, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës;
- **Marte Fetaj** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social;
- **Altin Lleshi** - Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike;

- **Jetmira Leka** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;
  - **Nikolin Shtjefni** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit;
  - **Denis Përvathi** - Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;
  - **Renaldo Xhanej** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës;
  - **Flamur Kuçi** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban;
  - **Brikena Vuksani** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit.
2. Grupi i punës të marrë në analizim, shqyrtim Planin Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030, në bashkinë Lezhë, të hartuar në mbështetjen e programit “Formimi i Migrimit të Orientuar drejt Zhvillimit” i financuar nga Qeveria Gjermane dhe i zbatuar nga GIZ-Shqipëri.
  3. Grupi i punës të marrë masa për realizimin e konsultimit publik për Planin Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030, në bashkinë Lezhë.
  4. Pas shqyrtimit dhe analizimit të Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030, në bashkinë Lezhë, koordinatori i grupit të marrë masa për dërgimin e këtij plani për miratim në Këshillin Bashkiak.
  5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet grupi i punës.
  6. Shfuqizimin e Urdhërit Nr. 500., datë 12.09.2022 “Për krijimin e grupit të punës për hartimin e strategjisë për diasporën dhe migracionin në bashkinë Lezhë”.
  7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
Pjerin Ndreu

